



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 505/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevi kryesues, Zyhdi Haziri dhe Ferki Xhaferi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të lartë ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik koalicionit NISMA-AKR-PD, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 24.11.2019, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa Anr.505/2019 me datë 22.11.2019, e paraqitur nga subjekti politik koalicioni NISMA-AKR-PD, me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) - Qendra e Numërimit dhe Rezultateve, me të cilën ka kërkuar që të shpallet i vlefshëm një fletëvotim në Vendvotimin 2413A/03D.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 22.11.2019, ka pranuar një ankesë Anr.505/2019 nga subjekti politik koalicioni NISMA-AKR-PD, në të cilën pretendon se me datë 22.11.2019, në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), gjatë rinumërimit të votave në kutin e vendvotimit 2413A/03D, vëzhguesi i tyre ka vërejtur se 1 fletëvotim që i përket subjektit politik koalicioni NISMA-AKR-PD me nr.122 është shpallur i pavlefshëm nga zyrtarët e QNR-së.

Parashtruesi i ankesës thekson se bazuar në Doracakun e Procedurave të Votimit dhe Numërimit të KQZ-së, sipas shtojcës nr.8 (Mostër e fletëvotimit të Pavlefshëm), ky fletëvotim duhet të shpallet i vlefshëm për arsye se “TIKU” është i vendosur në mënyrë të rregullt në rubrikën e koalicioni NISMA-AKR-PD nr.122, prandaj kërkojnë nga PZAP-i, që ankesa të aprovohet dhe këtë fletëvotim nga vendvotimi nr. 2413A/03D, ta shpallë të vlefshëm dhe ta obligoj KQZ-QNR që këtë ta vendos në rezultatin përfundimtar të koalicionit të NISMA- AKR- PD nr.122.

Në përgjigjen e KQZ-së, të pranuar me datë 23.11.2019, në rastin e vendvotimit 2413A/03D fletëvotimi është shpallur i pavlefshëm për arsye se janë të shënuara 2 subjekte politike dhe nuk dihet qëllimi i qartë i votuesit.

PZAP-i, pas shqyrtimit të ankesës, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe vlerësimit të provave të bashkangjitura, në ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Nga shkresat e lëndës konstatohet se në vendvotimin: 2413A/03D është shpallur nga ana e QNR-së, një fletëvotim i pavlefshëm, për shkak se shenja TIKU është i vendosur në dy katror të subjekteve të ndryshme politike. Si rezultat i këtyre konstatimeve QNR-ja, me rastin e rinumërimit e ka shpallur të pavlefshme këtë fletëvotim.

Subjekti politik koalicioni NISMA-AKR-PD, si palë ankuese ka paraqitur ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1 të LZP-së dhe nenit 8 par. 1 të Rregullores Zgjedhore NR. 06/2013, brenda afatit ligjor kur ka kërkuar nga PZAP-i, që ky fletëvotim të shpallet i vlefshëm.

Paneli ka gjetur se nuk qëndron pretendimi i ankuesit se pa të drejtë një fletëvotim i gjetur në kutitë e vendvotimit 2413A/03D është shpallur i pavlefshëm, pasi që nga ekzaminimi i të njëjtit ka rezultuar se ky fletëvotim nuk e përmbush asnjërin kriter të vlefshmërisë, pasi që shihet qartë ku preken dy rubrika të dy subjekteve të ndryshme politike, dhe e njëjta duhet të llogaritet e pavlefshme sepse nuk mund të vërtetohet qëllimi i votuesit.

PZAP-i, më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura vendimin e ka bazuar në nenin 119 paragrafi 5 të LZP-së, ku parashihet se, PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze”, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, Paneli në kuptim të nenit 117 dhe nenit 118 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr. 505/2019 më datën 24.11.2019**



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.